




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA GJIROKASTËR



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1505 Prot, datë 21.03.2017

Nr. 302 Prot, datë 24.03.2017

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET  
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
DHE  
BASHKISË GJIROKASTËR**

Sot me datë 24/03/2017 lidhet memorandum bashkëpunimi ndërmjet:

**Bashkisë Gjirokastrë**, me seli ne adresen "Sheshi Çerçiz Topulli", Gjirokastrë, përfaqësuar nga znj. Zamira Rami në cilësinë e Titullarit të Institucionit,

Dhe

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, me seli adresen Rr. Sami Frashëri, Nr 10, përfaqësuar nga znj. Irma BARAKU

në vijim të quajtura "Palët", te cilat:

- *Duke vlerësuar* rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;
- *Duke u angazhuar* për marrjen përsipër për sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- *Duke konsideruar* si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë;
- *Duke afirmuar* vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;
- *Duke u mbështetur* në EU-CoE Joint Programme "Enhancing the effectiveness of the Albanian system of human rights protection and anti-discrimination";

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim "*Memorandum*").

## **Baza Ligjore**

Memorandumi i Bashkëpunimit, mbështetet në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative, në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*"; në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*"

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është, bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkisë Gjirokastër, me qëllim ndjekjen, kujdesjen, garantimin, ofrimin e shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit, për marrjen pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në funksion të respektimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi.

### **Neni 2 Forma e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi:

1. Realizohet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një sporteli pilot në varësi nga Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ambjentet e Bashkisë Gjirokastër. në të cilin: jepet informacion mbi zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, informacion mbi Ligjin dhe mënyrën e ankesës pranë Komisionerit. Gjithashtu sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin i qytetarve për çështjet e mosdiskriminimit, për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme.

2. Bashkia Gjirokastrë merr përsipër sigurimin e ambjentit për sportelin pilot të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në projektin EU-CoE Joint Programme "Enhancing the effectiveness of the Albanian system of human rights protection and anti-discrimination", merr përsipër plotësimin e të gjitha nevojave të tjera për funksionimin e sportelit pilot: pagën e nëpunësit, pajisjet e zyrës dhe kompjuterike, kancelaritë etj.
4. Nëpunësi në sportelin pilot do të: asistojë qytetarët për plotësimin e formularit të ankeses për diskriminim; organizojë aktivitetet e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; bashkërendimit në dhënien e informacionit lidhur me ankesat e paraqitura nga subjektet e ligjit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, apo përcjelljen për shqyrtim të Komisionerit të informacioneve për raste të identifikuara; realizojë shkëmbimin e përbashkët të statistikave që kanë për bazë numrin e rasteve të raportuara për çështjet e diskriminimit edhe pranë strukturave të Bashkisë Gjirokastrë, apo të statistikave të tjera që kanë lidhje me diskriminimin, me qëllim analizimin e tyre për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e mbrojtjes në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe garantimin e barazisë para ligjit;
5. Bashkëpunimit edhe nëpërmjet formave të tjera për të cilat palët mund të bien dakord në të ardhmen.

### **Neni 3 Komunikimi mes palëve**

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për realizimin e zbatimit të këtij memorandumi.
2. Palët vendosin me vullnetin dhe dëshirën e tyre që mënyra e shkëmbimit të informacionit reciprok të punëve midis tyre, të jetë në formë shkresore, me përjashtim të rasteve urgjente ku forma e koordinimit të punëve dhe shkëmbimit të informacionit realizohet nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar.

### **Neni 4 Caktimi i personit**

1. Palët caktojnë një person që është përgjegjës për plotësimin e formularin e ankesës, dhënien e informacionit për qytetarët dhe shkëmbimin e informacionit dhe të kërkesave të palëve në zbatim të memorandumit.
2. Personi është i disponueshëm për komunikimin dhe koordinimin me palën tjetër me qëllim rakordinin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

### **Neni 5 Ndryshimi i Memorandumit**

1. Ndryshimet në këtë memorandum bëhen me dëshirën e vullnetin e palëve.
2. Mënyra e paraqitjes së propozimeve për ndryshime në përmbajtjen e këtij memorandum realizohet me shkrim në rrugë zyrtare, me anë të së cilit përcaktohet edhe afati kohor i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara të secilës palë.
3. Në rast mosmarrëveshjes ose keqkuptimesh në zbatimin e këtij memorandum, ndryshimi i tij realizohet vetëm nëpërmjet konsensusit dhe mirëkuptimit të palëve.

## **Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

## **Neni 7 Përfundimi i Memorandumit**

1. Duke u bazuar në rregullin e caktuar në pikën 1 të këtij neni, palët detyrohen midis tyre të njoftojnë me shkrim në rrugë zyrtare për përfundimin e këtij memorandum. Përfundimi hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

## **Neni 8 Hyrja në Fuqi**

1. Memorandum përgatitet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe 2 (dy) të tjera në Bashkinë Gjirokastrër.
2. Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të palëve.

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet sot më datë 24 / 03 /2017.

**KRYETAR I BASHKISË  
GJIROKASTËR**

**ZAMIRA RAMI**



**KOMISIONERI PËR  
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

